



|   |                             |
|---|-----------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO   |                             |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE |                             |
| Dep. <u>2-D/DPK</u>                                       | No. Prot. <u>01-3519/13</u> |
| Nr.faq  | Prot. No.                   |
| Broj stranaica <u>02</u>                                  | Data <u>24.10.2013</u>      |
| Nr. pages   | Date                        |
| PRISHTINE   |                             |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 (paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.10.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2434/13, për z. Emrush Kastrati – Anëtar i Komisionit të Pavarur për Media, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-2434/13, për zyrtarin e lartë z. Emrush Kastrati – Anëtar i Komisionit të Pavarur për Media, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin individual “Avokat Emrush Kastrati”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Kastrati është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe atij i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Në këtë takim ai ka konfirmuar se në cilësinë e zyrtarit të lartë e ushtron pozitën e Anëtarit në Komisionit e Pavarur për Media, dhe njëkohësisht është person i autorizuar në biznesin privat “Avokat Emrush Kastrati” (avokat).

Zyrtari i lartë publik ka kuptuar situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, prandaj pas rekomandimit të Agjencisë, ka premtuar se do të dorëhiqet nga pozita e Anëtarit në Komisionin e Pavarur për Media dhe do të ushtroj profesionin e tij të avokatisë.

Ndërkohë, z. Kastrati, në Agjenci ka dërguar një shkresë zyrtare (DPKI 03-2765/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka dhënë dorëheqje nga pozita e Anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media.

Pas kësaj, Agjencia ka bërë kërkesë me shkrim në Komisionin e Pavarur për Media dhe në Kuvendin e Kosovës me qëllim që të njoftohet zyrtarisht me statusin e z. Kastrati në Komisionin e Pavarur të Mediave.

Si rezultat, kemi pranuar përgjigje me shkresë zyrtare nga Komisioni i Pavarur për Media në të cilën vërtetohet se kanë pushuar të drejtat dhe obligimet e z. Emrush Kastrati si ish-anëtar i këtij Komisioni.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se është shmangur situata e mundshme të konfliktit të interesit.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

